# AKT-THEMELUES
## (KONTRATË)
## E SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE "MERKAJ" SH.P.K

Në mbështetje të Ligjit nr 7512 dt 10.8.1991, ligjës nr.7638 dt 10.11.1992"Për shoqëritë tregtare", ligjës nr7667 dt 28.01.1993" Për regjistrin tregtar" , kërkuesi Fatmir Merkaj , i biri iZalos dhe i Sofijes, dt .lindja 7.9.1969 , banues në Polican të rrethit Skrapari me shtetësi e kombësi shqiptare , ra dakort të lighë këtë kontratë si vijon :

**FORMIMI**

**Neni 1** Të krijojë shoqërinë tregtare private "MERKAJ", shoqëri e cila do të jetë me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen dhe legjislacionit të vendit ku do të ketë selinë dega . Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në bazë të kësaj kontrate dhe statusit të shoqërisë.Degët e shoqërisë do të veprojnë për llogari të kësaj shoqërie dhe brënda kopetencave të dhëna atyre .

**VENDQËNDRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 2** Vendqëndrimi i Shoqërisë Tregtare Private"MERKAJ" është në qytetin e Policanit të rrethit Skrapar .Shoqëria do të hapë dhe vendqëndrime të tjera të dyta, degë, përfaqsi, axhensi në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kopetente dhe jashtë vendit.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**Neni 3** Shoqëria private "MERKAJ" do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushat :

Tregtimine artikujve ushqimor, industrial, elektro-shtëpiak, duhancigare, fruta perime të freskëta e të konservuara, pije alkolike e freskuese, materiale ndërtimi,naftë e nënprodukte të saj,, grumbullim dhe tregtim të artikujve bujqësor e blegtoral, gjë e gjallë , dhe cdo lloj tjetër artikulli me objekt shitblerje , duke përfshirë automjetet e reja e të përdorura dhe pjesët e këmbimitt të tyre, me shumicë e pakicë, import-eksport , si dhe spedicionin e brëndshëm dhe të jashtëm transportin interurban dhe internacional të mallrave e të pasagjerëve, kinkaleri, plehra kimike, pesticide, bimë medicinale, Bar-bufe, lëndë drusore, karburante, shitje karburanti,vajguri, vajra lubrifikante , brënda vendit,tregtimin e mishit epeshkut etj.

F.Merkaj

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 4 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar e mbi 15 vjet dhe mund të shpërbëhet në cdo kohë e për cfarëdo shkaku . Asambleja e shoqërisë vendos për mënyrën e likujdimit dhe cakton likujdatorë .

## KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5 Kapitali fillestar i Shoqërisë Tregtare Private "MERKAJ" do të jetë 100.000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë ku njëra pjesë është e barabartë me 1000 lekë .

## DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 6 Organet drejtuese të Shoqërisë tregtare private "MERKAJ" janë :

- Ortaku i vetëm.
- administratori

Shoqëria do të drejtohet nga ~~Asambleja e shoqërisë~~ dhe pikërisht nga administratori dhe ortaku i vetëm z;Fatmir Merkaj .

Neni 7 Raporti i administrimit, iventari dhe llogarit vjetore hartohen nga administratori.

Ortaku i vetëm miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brënda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku i vetëm mund ti delgojë kopetencat e tij . Vendimet e tij të marra në vend të asamblesë , evidencohen në një regjistër. Vendimet e marra në kundërshtim me përmbajtjen e këtij neni mund të anullohen me kërkesë të cdo personi të interesuar .

Neni 8 Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme e me tekstin e saj Shoqëria tregtare private "MERKAJ" SH.P.K -Skrapar .

Neni 9 Konfliktet që mund të krijohen midis palëve në këtë shoqëri do të gjykohen në Gjykatën e rrethit Skrapar, sipas statusit të shoqërisë, kontratës së lidhur me palët dhe legjislacionit shqiptar në fuqi .

Neni 10 Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të normave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi e vecanërisht të ligjës nr.7667 dt 19.2.1992 " Mbi krijimin e shoqërive tregtare" , me regjistrimin e saj në Gjykatën e rrethit . Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejës nga organet kopetente.

Neni 11. Akti i themelimit u hartua në 4 kopje të cilat shpërndahen në Degën e Taksa Tatimeve , gjykatën e rrethit, në Zyrën Noteriale dhe një kopje në dokumentacionin bazë të shoqërisë private "MERKAJ" sh.p.k .

Akti i themelimit nënshkruhet nga Ortaku i vetëm.

Nr. [illegible] 255361

FATMIR MERKAJ

S T A T U T I

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE " MERKAJ" SH.P.K POLICAN-SKRAPAR

Në bazë të Ligjit nr.7512 dt 10.8.1991" Për sanksionimin e mbrojtjen e pronës e veprimtaris private " dhe ligjit nr. 7638 dt 19.02.1992" Për shoqëritë tregtare" , ligjit nr.7667 dt 28.01.1993" Për regjistrin tregtar" dhe vullnetin e tij të lirë të shprehur në nënshkrimin e kontratës që i bashkangjitet këtij statuti, ortakët të vetëm z. Fatmir Merkaj sot më datë 21.11.1995 duke patur zotësi të plotë për të vepruar shpallim si vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE "MERKAJ"
ME ORTAKË TË VETËM .

Neni. 1 Formohet Shoqëria Tregtare Private "MERKAJ" import eksport me themelues :

1. Fatmir Merkaj , i biri Zalos, dt .lindja 7.9.1969 banues në Polican -Skrapar.

F O R M A

Neni.2 Shoqëria Tregtare Private " MERKAJ" është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit, kapitalit themeltar .

VENDQËNDRIMI I SHOQËRISË

Neni .3 Shoqëria Tregtare Private "MERKAJ" SH.P.K ka vendqëndrimin e saj në qytetin e Policanit të rrethit Skrapar . Shoqëria mund të hapi dhe vendqëndrime të dyta, degë, përfaqsi axhensi në gjithë territorin e Reprublikës së Shqipërisë dhe miratim të organeve kopetente dhe jashtë vendit .

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni .4 Kohëzgjatja e Shoqërisë Tregtare Private "MERKAJ" sh.p.k do të ketë një kohëzgjatje të veprimtaris së saj ekonomike me një afat të pacaktuar e mbi 15 vjet dhe mund të shpërbëhet në cdo kohë e përcfarëdo shkaku.

OBJEKTI I VEPRIMTARIS

Neni . 5 Objekti i veprimtaris së Shoqërisë"MERKAJ" do të jetë : Tregtimi i artikujve ushqimorë, industrial, elktroshtëpiak, duhan cigare, fruta perime të freskëta e të konservuara, pije alkolike e freskuese, materiale ndërtimi ,naf-

FMerkaj

-të e nënprodukte të saj, grumbullim e tregtim të artikujve bujqësor e blegtoral, gjë e gjallë dhe cdo lloj tjetër artikulli me objekt shitblerje, duke përfshirë automjetet e reja e të përdorura dhe pjesët e këmbimit të tyre, me shumicë e pakicë import-eksport, si dhe spedicionin e brëndshëm dhe të jashtëm, transportin interurban dhe internacional të mallrave e të pasagjerëve, kinkaleri, plehra kimike, pesticide, bimë medicinale, Bar-bufe,karburante, shitje karburanti, vajguri, vajra lubrifikante, këndë drusore brënda vendit, tregtimin e mishit , të peshkut, etj .

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni.6 Kapitali fillestar i Shoqërisë Tregtare Private "MERKAJ" është 100.000 lekë, i përbërë nga kapitali i vetëm i ortakut themelues. Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të ndryshojë. Kapitali fillestar është i depozituar në një bankat e rrethit Skrapar dhe i ndarë në 100 pjesë ku një pjesë është e barabartë me 1000 lekë .

Neni .7 Pjesmarrja në kapitalin themeltar shënohet në statut. Fondet në para që vajnë nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar, depozitohen brënda një afat 8-ditor pranë një noteri apo bankë. Në statut parashikohet që tërheqja e fondeve qp vijnë nga shlyerja e kapitalit themeltar bëhet nga vetë ortaku e administratori i shoqërisë me paraqitjen e një certifikate që vërteton regjistrimin e shoqërisë, në regjistrin tregtar.

Neni.8 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar , mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme, të lujtshme e të palujtshme.

Neni . 9 Shoqëria tregtare private "MERKAJ" është përdoruese e disponuese e pasuris së saj.Ajo mund të blejë e shfrytëzojë të drejta të tjera materiale ose jo materiale, duke përfshirë të drejtën e shitjes së vetë me të tjerët. Në Republikën e Shqipërisë kjo shoqëri gëzon të drejta në përputhje me legjislacionin shqiptar ose të huaj, sikundër cdo person tjetër juridik.

Neni .10 Shoqëria tregtare private "MERKAJ" sh.p.k veprom në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brënda kapitalit të saj .

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni . 11 Organet drejtuese të Shoqërisë Tregtare Private

F.Merkaj

" MERKAJ" sh.p.k do të jenë:

-Ortaku i vetëm.

-Administratori.

Fusha e veprimit,përbërja e mënyra e punës së organeve drejtuese do të jetë e parashikuar në statut.

Neni. 12 Shoqëria drejtohet nga ortaku i vetëm dhe administratori i saj z. Fatmir Merkaj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni. 13 Shoqëria Tregtare Private "MERKAJ" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përfshin ky statut, akti themelues dhe legjislacionit shqiptar në fuqi . Shoqëria fiton zotësinë e saj për të vepruar me regjistrimin e saj në Gjykatën e rrethit Tiranë dhe fillon ushtrimin e veprimtaris së saj ekonomike me regjistrimin në organet përkatëse tatimore .

Neni . 14 Shoqëria ka vulën e saj. Shoqëria Tregtare Private"MERKAJ" SH.P.K Import-Eksport.

Neni . 15

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë me një ortak të vetë ushtrohet prej tij si administrator i vetëm . Ai mund ti delegojë kopetencat e veta.Vendimet e tija të marra në vend të asamblesë evidencohen në një regjistër. Raporti i adiministrimit, iventari dhe llogaritë hartohen nga administratori .

Neni. 16 Administratori i Shoqërisë cakton administrator të tjerë të cilëve në aktin e emërimit i cakton detyrat dhe pagën. Kështu vepron dhe për punëtorët e punonjësit e punësuar . Shoqëria merr përsipërt të zbatojë e respektojë rregullat e punësimit në bazë të K.Punës, ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë statuin e shoqërisë dhe kushtet e parashikuara në kontratën e punës . Për çështjet që nuk parashikohen në kontratën e punës dotë rregullohen e të zbatohen dizpozitat mbi Kodin e Punës ..

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni . 17 Bilanci vjetor i Shoqërisë bëhet në fund të muajit dhjetor përvec rasteve t ë vecanta që kryen vetë administratori i shoqërisë .Në fund të cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanc kontabël në fitime, humbje sipas rastit. Me krijimin e miratimin e bilancit kontabël, administratori vendos krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme si fondin e akumulimit,fondin rezervë , etj .

F. Merkaj

Neni. 18

Të ardhurat neto të realizuara, pas pagimit të detyrimit fiskal dhe krijimit të fondeve të përmëndura më lartë , i mbesin ortakut themelues.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni. 19 Shpërbërja e Shoqërisë mund të vijë në cdo kohë e për cfarëdo shkaku, si humbja e kapitalit të shoqëirsë, pamundësi veprimi ose me vullnet të vetë ortakut.

Administratori i shoqërisë vendos për mënyrën likujdimit duke caktuar likujdatorë dhe detyrat e tyre . Ai vendos për likujdimin e detyrimeve me të tretët që ka shoqëria.

DIZPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni. 20

Përsa nuk është shprehur në këtë statut , i referohet plotësimeve të reja që do të bëjë ortaku themelues , në bazë të ligjeve në fuqi. Ndryshimet e plotësimet në këtë statut bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën u hartua statuti.

Neni .21

Ky statut hartohet në disa kopje, të cilat ju shpërndahen orgeneve kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë .

Ky statut i miratuar nga ortaku i vetëm themelues nënshkruhet rregullisht prej tij .

ORTAKU THEMELUES
Fatmir Merkaj

Nr. Ukrajofhim 1 25536 P

[signature]